# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8258
E martë, 10 mars 2026
Çmimi 0. 50 €


## Në krah të ShBA-së kundër Iranit, sa e sigurt është Kosova?

FAQE 6-7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


LËVIZJA VETËVENDOSJE E KA DËRGUAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE DEKRETIN E VJOSA OSMANIT PËR SHPËRNDARJEN E KUVENDIT, PRESIDENCA NË PRITJE TË VENDIMIT

# A PO SHKON KOSOVA DREJT NJË KRIZE TË RE INSTITUCIONALE?

FAQE 4-5




Lëvizja Vetëvendosje është ankuar zyrtarisht të hënën në Gjykatën Kushtetuese kundër dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, teksa Presidenca njoftoi se po e pret vendimin e gjykatës më të lartë të vendit para se të vendosë të shpallë apo jo datën për zgjedhjet e reja. Opozita ka theksuar se shumica parlamentare po e çon vendin drejt zgjedhjeve të reja, një krize të panevojshme politike dhe përplasjeve kushtetuese



## ‘KËTË E KEMI BËRË PËR TY’. RASHIQ MUNDOHET TA ARSYETOJË DEKLARATËN PËR TOKËN E MANASTIRIT TË DEÇANIT, KURTI NUK U PËRGJIGJET GAZETARËVE F. 4-5

## INSPEKTORATI I TREGUT ME MBIKËQYRJE INTENSIVE PËR ÇMIMIN E DERIVATEVE NË TREG F. 6




## AKTUALE



### NËN UDHËHEQJEN E MOJTABA KHAMENEIT, IRANI NIS SULME KUNDËR IZRAELIT DHE VENDEVE TË GJIRIT F. 2

### KOSOVA DHE SHQIPËRIA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E EKIPEVE TË PËRBASHKËTA HETIMORE F. 5

### EKSTRADOHEN NGA SHQIPËRIA PËR NË KOSOVË, DY TË KËRKUAR ME LETËR RRESHTIM NDËRKOMBËTAR F. 3

## EKONOMI



### BIZNESET KËRKOJNË LEHTËSIM TË PROCEDURAVE PËR MALLRAT TRANZIT NGA PORTI I DURRËSIT F. 8

### 206.9 MILIONË EURO TË HYRA NGA TATIMET NË DY MUAJT E PARË TË KËTIJ VITI F. 8

## SPORT



### SUPERLIGA E KOSOVËS: DRITA E PARA, DRENICA E FUNDIT F. 11


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# NËN UDHËHEQJEN E MOJTABA KHAMENEIT, IRANI NIS SULME KUNDËR IZRAELIT DHE VENDEVE TË GJIRIT



TEHERAN, 9 MARS - Irani shënoi orët e para pas emërimit të Mojtaba Khameneit si udhëheqës suprem të vendit duke lëshuar raketa dhe dronë drejt Izraelit dhe shteteve arabe të Gjirit, të cilat sa shkojnë e zemërohen më shumë për sulmet hakmarrëse të Teheranit. "Irani lëshoi valën e parë të raketave nën udhëheqjen e Ajatollah Sejed Mojtaba Khameneit drejt territoreve të pushtuara", bëri të ditur transmetuesi shtetëror iranian IRIB përmes një postimi në Telegram më 9 mars.

Postimi shoqërohej me një fotografi të një predhe ku shkruhej: "Me urdhrin tuaj, Sejid Mojtaba".

Transmetuesi shtetëror tha se në qendër të territoreve të pushtuara janë dëgjuar "shpërthime të mëdha". Izraeli njoftoi se një grua mbeti e plagosur nga sulmet.

Arabia Saudite, Katari, Kuvajti, Bahrejni, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Iraku raportuan gjatë natës se raketa dhe dronë u nisën drejt tyre, teksa Teherani intensifikon sulmet dhe lufta e Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit kundër Iranit vazhdon të përhapet në rajon.

## Njoftimi i mesnatës

Pak para mesnatës, më 9 mars, Irani emëroi figurën e linjës së ashpër Mojtaba Khamenein për të zëvendësuar babain e tij, Ajatollah Ali Khamenein, si udhëheqës suprem. Ky vendim mund ta bëjë atë shënjestër direkte të ushtrive amerikane dhe izraelite.

Khamenei, 86-vjeçar, u vra më 28 shkurt kur forcat amerikane dhe izraelite nisën luftën kundër Iranit. Zyrtarë amerikanë dhe izraelitë, përfshirë presidentin amerikan Donald Trump, kanë paralajmëruar se çdo udhëheqës i ri mund ta ketë fatin e njëjtë sikurse të paraardhësit të tij.

## "Zgjedhje e papranueshme"

Trump e kishte quajtur më herët emërimin e Mojtaba Khameneit në krye të Iranit si "zgjedhje të papranueshme" dhe "figurë të dobët", duke këmbëngulur se kushdo që zgjidhet nga Teherani duhet të jetë i pranueshëm për Uashingtonin.

Në një intervistë për transmetuesin ABC News, Trump tha se "nëse ai [udhëheqësi i ardhshëm suprem] nuk merr miratimin tonë, nuk do të zgjasë shumë", duke shtuar se ka "shumë njerëz që mund të kualifikohen" për këtë rol.

Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC) premtoi menjëherë mbështetje për Khamenein, i cili besohet se ka lidhje të ngushta me këtë organizatë ushtarake të linjës së ashpër. Edhe shefi i forcave të rregullta të armatosura e përshëndeti emërimin që shihet si fitore për mbështetësit e linjës radikale.

Kreu i gjyqësorit iranian, Gholamhossein Mohseni Ejei, e quajti zgjedhjen e Khameneit "burim gëzimi dhe shprese".

Si udhëheqës suprem, Khamenei 56-vjeçar do të ketë fjalën e fundit në të gjitha çështjet politike dhe ushtarake, duke ushtruar pushtet pothuajse absolut në vend.

Në një intervistë për të përditshmen Times of Israel, Trump refuzoi të komentonte drejtpërdrejt emërimin e liderit të ri, duke thënë vetëm se, "do të shohim se çfarë do të ndodhë."

## Irani shënjestron shtetet e Gjirit

Pak pas emërimit, Irani e nisi një breshëri raketash dhe dronësh iranianë në gjithë rajonin.

Një nga sulmet më të rënda duket se ndodhi në Bahrejn, ku Ministria e Shëndetësisë më 9 mars tha se një sulm me dron iranian plagosi 32 civilë.

Katër prej të plagosurve janë në gjendje të rëndë, përfshirë edhe fëmijë, njoftoi ministria.

Dëshmitarët raportuan më vonë se panë tym të dendur që ngrihej nga drejtimi i rafinerisë së naftës Bapco në Bahrejn, sipas agjencisë së lajmeve, Reuters. Rafineria ishte goditur nga raketat iraniane edhe katër ditë më parë, duke shkaktuar dëme të kufizuara.

Shpërthimet e 9 marsit tronditën edhe kryeqytetin e Katarit, Doha, i cili është shënjestruar nga valë dronësh dhe raketash iraniane prej kur Irani nisi fushatën e gjerë të hakmarrjes në Gjirin Persik.

Ministria e Jashtme e Arabisë Saudite paralajmëroi se sulmet e vazhdueshme të Iranit do të çojnë në përshkallëzim të mëtejshëm dhe do të kenë "ndikim serioz" në marrëdhënie "tani dhe në të ardhmen".

Ajo i dënoi "sulmet e hapura iraniane kundër një numri vendesh arabe dhe shënjestrimin e civilëve, objekteve jetike dhe misioneve diplomatike."

Departamenti amerikan i Shtetit urdhëroi personelin diplomatik jo të domosdoshëm dhe familjet e tyre në Ambasadën në Riad që të largohen nga Arabia Saudite, për shkak të shqetësimeve për sigurinë.



## Sulme edhe në Kurdistanin e Irakut

Burime të sigurisë thanë se dronët goditën pranë një baze ushtarake amerikane afër Erbilit, në Kurdistanin irakian.

Forcat e sigurisë thanë se kapën një seri dronësh dhe raketash që synonin një postë diplomatike amerikane pranë aeroportit të Bagdadit.

Mijëra kurdë iranianë kanë ngritur baza në rajonin gjysmë-autonom të Kurdistanit irakian. Edhe pse mbajnë lidhje mes tyre, kurdët iranianë ruajnë milici të ndara nga kurdët e Irakut në këtë rajon.

Disa raportime sugjerojnë se kurdët iranianë - brenda dhe jashtë Iranit - mund të nisin ofensivë kundër regjimit në Teheran. Megjithatë, Trump ka thënë se nuk dëshiron që kurdët t'i bashkohen përpjekjes ShBA-Izrael, pasi nuk dëshiron t'i shohë ata "të plagosur ose të vrarë" apo ta ndërlikojë më tej situatën.

Izraeli tha vonë më 9 mars se nisur një valë sulmesh që synojnë "infrastrukturën e regjimit" në qendër të Iranit, si reagim të parë pas shpalljes së udhëheqësit të ri suprem.

Ndërkohë, kaosi në sektorin e naftës në Lindjen e Mesme dhe në transportin detar rezultuan me rritje të çmimeve të naftës më shumë se 25 për qind më 8 mars, çka mund të dëmtojë ekonominë globale.

Trump tha se rritja e çmimeve të naftës është "një çmim i vogël për t'u paguar" për të eliminuar kërcënimin bërthamor të Iranit.

Trump dhe Izraeli e akuzojnë Iranin se po përpiqet të ndërtojë armë bërthamore, ndërsa Teherani këmbëngul se programi i tij është vetëm për qëllime civile.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# ‘KËTË E KEMI BËRË PËR TY’. RASHIQ MUNDOHET TA ARSYETOJË DEKLARATËN PËR TOKËN E MANASTIRIT TË DEÇANIT, KURTI NUK U PËRGJIGJET GAZETARËVE



EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 9 mars** - Ministri për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashiq, e tërhoqi deklaratën e tij se kryeministri Albin Kurti, për shkak të tij, i ka kërkuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës në mars të vitit 2024 të zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nga viti 2016 për kthimin e tokës te Manastiri i Deçanit.

Në një intervistë për radion lokale, Radio Gorazhdevci, Rashiq tha se Kurti i ka thënë atëkohë: “Këtë e kemi bërë për ty”. “Deklarata ime nuk ishte plotësisht e saktë, sepse e ngatërrova atë fjali me një bisedë që ndodhi më parë, kur miratova vizitën e Patriarkut serb. Gabimi im ishte i paqëllimshëm dhe ndërrimi i ngjarjeve ndodhi sepse kanë kaluar disa vite që nga ajo kohë”, tha Rashiq në reagimin dërguar mediave.

Deklarata e Rashiqit se 24 hektarë tokë iu kthyen Manastirit të Deçanit për shkak të tij, nxiti reagime të shumta, ndërsa zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Arlind Manxhuka, e mohoi menjëherë atë.

Ai deklaroi se çështja e zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, u sqarua qartë në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës dhe në konferencën për shtyp më pas, dhe se ishte kusht i Këshillit të Evropës kur Kosova aplikoi për anëtarësim në këtë organizatë.

“Ajo çka ka ngatërruar ministri Nenad Rashiq, është pranimi i kërkesës së tij për vizitë të Patriarkut Porfirije, për Krishtlindjet ortodokse të vitit 2023, siç mund ta shihni në fotografinë më poshtë”, shkroi Manxhuka në një postim në llogarinë e tij në “Facebook”.

Kryeministri Kurti të hënën refuzoi të ndalet për t’iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve lidhur me deklaratën e Rashiqit, duke theksuar se ka reaguar zëdhënësi i Qeverisë, Arlind Manxhukës dhe vetë ministri.

Ish-kryeministri, Ramush Haradinaj, ka reaguar në lidhje me deklaratën e ministrit për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq. Për këtë, ai ka ironizuar me një fjalë popullore. “Çka ka shtëpija, tregon fëmija”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Enver Hoxhaj, nga Partia Demokratike e Kosovës në opozitë, vlerësoi se deklarata e Rashiqit tregon se Qeveria e Kurtit ndjek politika me “logjikë feudale”, sepse territori i shtetit trajtohet si pronë që jepet “për hatër” të dikujt. “Nenad Rashiq tha publikisht se Albin Kurti, për hatër të tij, ia ka transferuar tokën Manastirit të Deçanit. Një deklaratë e tillë tregon thelbin e një politike me logjikë feudale, ku territori i shtetit trajtohet si pronë për t’u dhënë ‘për hatër’. Pyetja që shtrohet është e thjeshtë, për hatër të kujt janë marrë edhe vendime të tjera të rënda për Kosovën? Për hatër të kujt u pranua vetëmenaxhimi në marrëveshjet e Ohrit dhe Brukselit më 2023? Për hatër të kujt u rikthye në qendër Rezoluta 1244 dhe mekanizma arbitrazhi që hapin rrugë për ekstraterritorialitet? Dhe për hatër të kujt u pranua që pasaportat e Serbisë për qytetarët e Kosovës të mund të përdoren për lëvizje pa viza në BE? Kosova nuk është pronë e askujt për t’u falur sipas hatrit. Është shtet dhe duhet të trajtohet si e tillë”, ka shkruar Hoxhaj.

Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se deklarata e ministrit Rashiq e zhvesh plotësisht Kurtin nga retorika e tij mashtruese. “Për vite u fol për ‘tradhti’ dhe ‘falje të tokës për manastirin’. Sot, ministri i tij e thotë hapur se vendimi për faljen e tokës së manastirit ishte shumë i thjeshtë: ‘Do ta bëjmë, por ta dish - për shkakun tënd’. Pra, ajo që dikur ishte tradhti, kur u bë vetë Kryeministër u bë lehtësisht për hatër. Kaq ‘serioze’ është vendimmarrja shtetërore e Kurtit. Hi syve për qytetarët, ndërsa vendime të kundërta e për hatër në prapaskenë”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.

Për vite me radhë, autoritetet lokale në Deçan refuzuan t’i lejonin Manastirit të regjistronte 24 hektarë tokë dhe pyje në kadastër, duke konsideruar se prona u përkiste ndërmarrjeve shoqërore “Apiko” dhe “Iliria”. Atëkohë, vlerësohej se Gjykata Kushtetuese kishte “legalizuar” vendimin e ish-presidentit të Republikës Federale të Jugosllavisë, Sllobodan Millosheviq, të vitit 1997, kur ai vendosi t'ia dhuronte pronën Manastirit të Deçanit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pas vendimit që tokat t’i ktheheshin Manastirit të Deçanit, tha se qëndrimi i tij ndaj “këtij vendimi më të dëmshëm ndonjëherë” nuk do të ndryshojë.

Megjithatë, ai shtoi se nuk ka asnjë dyshim që anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës “nuk do të ishte vetëm një fitore historike, por edhe një hap gjigant” drejt njohjes së Kosovës nga pesë shtetet e BE-së që nuk e kanë marrë ende një vendim të tillë.

## Ekstradohen nga Shqipëria për në Kosovë, dy të kërkuar me letër rreshtim ndërkombëtar

**Prishtinë, 9 mars** - Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor, në koordinim dhe në bashkëpunim me njësitet tjera relevante të Policisë së Kosovës dhe me institucionet e drejtësisë, më 9 mars, ka bërë ekstradimin e dy shqiptar, nga Shqipëria për në Kosovë.

Të njëjtit ishin arrestuar nga autoritetet shqiptare pasi që kërkoheshin përmes INTERPOL-it me letër rreshtim ndërkombëtar lëshuar nga institucionet e drejtësisë së Kosovës, të përfshirë në raste të ndara, njëri për veprën penale ‘kultivim i lëndëve narkotike’, ndërsa tjetri për veprën penale ‘vjedhje e rëndë’.

Të dy ekstradimet u realizuan bazuar në ligjet në fuqi dhe falë bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe atyre shqiptare, ndërsa pas ekstradimit të dyshuarit iu dorëzuan njësiteve përkatëse të policisë së rajonit të Pejës, përkatësisht atij të Prizrenit.

Policia e Kosovës nëpërmjet njësive të saj, do të vazhdojë me shkëmbimin e informacioneve me institucionet vendore, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare, me qëllim të parandalimit, hetimit dhe zbulimit të aktiviteteve kriminale që ndërlidhen me hetimin e kryesve të veprave penale.






LËVIZJA VETËVENDOSJE E KA DËRGUAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE DEKRETIN E VJOSA OSMANIT PËR SHPËRNDARJEN E KUVENDIT, PRESIDENCA NË PRITJE TË VENDIMIT

# A PO SHKON KOSOVA DREJT NJË KRIZE TË RE INSTITUCIONALE?

Lëvizja Vetëvendosje është ankuar zyrtarisht të hënën në Gjykatën Kushtetuese kundër dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, teksa Presidenca njoftoi se po e pret vendimin e gjykatës më të lartë të vendit para se të vendosë të shpallë apo jo datën për zgjedhjet e reja. Opozita ka theksuar se shumica parlamentare po e çon vendin drejt zgjedhjeve të reja, një krize të panevojshme politike dhe përplasjeve kushtetuese

EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 9 mars** - Partia në pushtet Lëvizja Vetëvendosje (LV) është ankuar zyrtarisht në Gjykatën Kushtetuese kundër dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, teksa Presidenca njoftoi se po e pret vendimin e gjykatës më të lartë të vendit para se të vendosë të shpallë apo jo datën për zgjedhjet e reja.

Shefja e grupit parlamentar të LV-së, Arbërie Nagavci, njoftoi në “Facebook” të hënën se krahas kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dekretit, i kanë kërkuar Gjykatës ta pezullojë përkohësisht dekretin e presidentes deri në nxjerrjen e aktgjykimit përfundimtar. “Është e qartë se Presidentja e Republikës nuk ka të drejtë diskrecionale për të ndërhyrë në funksionimin e pushtetit legjislativ, e aq më pak për të ndërmarrë veprime që çojnë në shpërndarjen e Kuvendit”, shkroi ajo.

Osmani e nxori më 6 mars dekretin për ta shpërndarë Kuvendin, gjë që do ta çonte vendin e zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Presidentja ende nuk e ka nënshkruar dekretin për datën e zgjedhjeve sepse është në pritje të vendimit të Kushtetueses, tha të hënën këshilltari i saj për media, Bekim Kupina. “Nëse Gjykata Kushtetuese e vlerëson si të nevojshme caktimin e një mase të përkohshme, Presidenca e mirëpret atë, duke ritheksuar se masa në asnjë moment nuk paragjykon vendimin përfundimtar të Gjykatës lidhur me kushtetutshmërinë e dekretit”, tha ai.

Osmani e ka arsyetuar këtë vendim, duke thënë se 5 marsi ka qenë afati i fundit për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës - meqë mandati i saj përfundon më 4 prill - por që deputetët kanë dështuar t’i përmbushin afatet ligjore.

Nagavci argumentoi se roli i presidentit në këtë proces “është strikt i kushtëzuar dhe aktivizohet vetëm në rrethanat e përcaktuara qartë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës”.

Më tej, Nagavci shtoi se “përpjekjet për të ushtruar kompetenca që nuk janë të përcaktuara qartë me Kushtetutë jo vetëm që dëmtojnë rendin kushtetues, por rrezikojnë edhe vetë funksionimin demokratik të institucioneve”.

Kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha të hënën se organi ligjvënës nuk mund ta vazhdojë punon derisa Kushtetuesja të nxjerrë një vendim.

Partia në pushtet thirret në nene të tjera të Kushtetutës dhe beson që dekreti nuk ka bazë, meqë procedurat për zgjedhjen e presidentit i ka nisur më 5 mars dhe ka afat prej 60 ditësh për ta finalizuar procesin.

Osmani, në anën tjetër, ngul këmbë se afati 60-ditor do të duhej të shfrytëzohej para 5 marsit dhe ajo e mbajti menjëherë një takim partitë politike për të folur për datën e zgjedhje të parakohshme.

Në takim morën pjesë kryetarë të partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por jo edhe partia e kryeministrit Albin Kurti.

Në seancën e 5 marsit, Lëvizja Vetëvendosje i paraqiti dy kandidatë për president: Glauk Konjufcën dhe Fatmire Kollçaku-Mullhaxhën.

Seanca u ndërprerë në mungesë kuorumi, pasi ishte braktisur nga partitë opozitare.

Disa juristë kanë interpretuar se Kuvendi do të duhet ta zgjedhë presidentin brenda 60 ditësh nga fillimi i seancës për zgjedhjen e presidentit.

Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, tha më 6 mars se dekreti i Osmanit ishte “jokushtetues”.

Sipas tij, Osmani nuk kishte të drejtë ta shpërndante Kuvendin dhe se deputetët, nga 5 marsi, kanë 60 ditë kohë për ta zgjedhur presidentit.

Presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para apo me 61 vota në rundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mundë të mbahet.

Për partitë opozitare, dy figurat e prezantuara nga LV-ja kanë qenë të papranueshme dhe ato kanë ngulur këmbë në marrëveshje politike ose të prezantohet një figurë konsensuale.
Palët kanë zhvilluar disa runde bisedimesh në javët e fundit, mirëpo nuk kanë arritur pajtueshmëri.
Vetë Osmani e ka synuar edhe një mandat të dytë, mirëpo emrin e saj nuk e ka propozuar askush. Për LV-në ajo nuk i ka pasur votat e nevojshme, ndërsa për partitë tjera ajo nuk e ka personifikuar unitetin e nevojshëm që i duhet figurës së presidentit.

### PDK-ja: Shumica parlamentare po e shtyn vendin drejt një krize të re institucionale

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Arian Tahiri, dhe deputeti Përparim Gruda, kanë folur për zhvillimet e fundit politike dhe situatën që po e çon vendin drejt zgjedhjeve të reja, një krize të panevojshme politike dhe përplasjeve kushtetuese.
Tahiri theksoi se Kosova po shkon sërish drejt zgjedhjeve jo për shkak të mungesës së alternativave për zgjidhje, por për shkak të refuzimit të tyre nga shumica parlamentare. “Nëse e di që nuk i ke votat, atëherë në politikë kërkon marrëveshje dhe konsensus. Por kur refuzon marrëveshjen dhe insiston vetëm në kandidatë partiakë, mesazhi është i qartë: problemi nuk është zgjedhja e presidentit, por dëshira për të kontrolluar çdo institucion të shtetit. Dëshira për t’i nënshtruar të gjithë akterët e tjerë politikë ndaj një mentaliteti autoritar, për ta kapur çdo institucion”, tha Tahiri gjatë një konference për medie.
Ai shtoi se të gjithë presidentët e deritanishëm të Kosovës janë zgjedhur si rezultat i marrëveshjeve ndërmjet partive politike dhe se kjo është hera e parë që Kuvendi dështon ta zgjedhë presidentin.
Tahiri theksoi se PDK-ja ka vepruar me përgjegjësi gjatë gjithë këtij procesi.
Ai tha se partia ka pranuar rezultatin e zgjedhjeve të 28 dhjetorit dhe ka marrë pjesë në takimet me kryeministrin Albin Kurti për të gjetur një zgjidhje.
Ai shtoi se PDK-ja ka mbështetur idenë e një kandidati konsensual nga familja Jashari, ka qenë e hapur për një marrëveshje gjithëpërfshirëse politike dhe në fund ka ofruar edhe një marrëveshje të kufizuar vetëm për zgjedhjen e presidentit. “Pra, alternativa kishte. Zgjidhje kishte. Mungoi vetëm vullneti politik i shumicës parlamentare. Ose, thënë më saktë: në Lëvizjen Vetëvendosje mbizotëroi etja dhe dëshira për pushtet dhe kontroll absolut”, u shpreh Tahiri.
Ai theksoi se për PDK-në ishte e papranueshme logjika e kontrollit absolut të institucioneve dhe se një qasje e tillë do t’i sillte dëme serioze vendit.
Tahiri tha gjithashtu se, pasi kanë kuptuar se nuk mund të prodhojnë rezultate konkrete për vendin, shumica parlamentare ka zgjedhur të abstenojë nga përgjegjësia e qeverisjes dhe të prodhojë kriza të njëpasnjëshme politike.
Në fund, Tahiri deklaroi se Partia Demokratike e Kosovës është e gatshme për zgjedhje sa herë që ato të mbahen. “PDK do t’u drejtohet qytetarëve me një program të qartë për stabilitet institucional, zhvillim ekonomik dhe qeverisje serioze. Kosova nuk ka nevojë për kriza të reja politike, Kosova ka nevojë për përgjegjësi”, përfundoi Tahiri.
Për të sqaruar aspektet kushtetuese të situatës aktuale, fjalën e mori deputeti i PDK-së, Përparim Gruda.
Gruda theksoi se Kuvendi i Kosovës ka dështuar ta zgjedhë presidentin brenda afatit të përcaktuar me Kushtetutë dhe se, si rrjedhojë, shpërndarja e Kuvendit është pasojë e drejtpërdrejtë kushtetuese. “Kuvendi i Kosovës ka konsumuar të drejtën e tij për të zgjedhur presidentin brenda afatit kushtetues. Për pasojë, shpërndarja e tij dhe dekreti i presidentes janë plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”, tha Gruda.
Ai theksoi se në doktrinën kushtetuese evropiane ekziston parimi i ndalimit të përfitimit nga mosveprimi institucional. “Kompetenca për zgjedhjen e presidentit nuk është diskrecionale, por një detyrim pozitiv kushtetues. Mosnisja e procedurës përbën një mosveprim kushtetues institucional që bllokon krijimin e një organi të shtetit”, deklaroi Gruda.
Sipas tij, interpretimi se Kuvendi mund të shmangë shpërndarjen duke mos e nisur fare procedurën e zgjedhjes së presidentit është në kundërshtim me logjikën kushtetuese dhe me parimin e efektivitetit të Kushtetutës. “Nëse pranohet se shpërndarja ndodh vetëm pas votimit të tretë, atëherë Kuvendi mund të mos e thërrasë kurrë seancën dhe të zgjasë mandatin përtej parashikimeve kushtetuese. Kjo bie ndesh me parimin e efektivitetit të Kushtetutës”, tha ai.
Gruda shtoi se interpretimi korrekt i Kushtetutës kërkon që afatet kushtetuese të mos neutralizohen përmes mosveprimit institucional. “Dispozitat kushtetuese nuk mund të interpretohen në mënyrë që lejojnë neutralizimin e tyre përmes mosveprimit institucional. Përndryshe, do të krijohej mundësia e një bllokimi të përhershëm institucional”, theksoi Gruda.
Ai përfundoi se Kuvendi ka shkelur Kushtetutën me mosveprim dhe se pasoja e kësaj situate është shpërndarja e tij dhe mbajtja e zgjedhjeve të reja. “Presidentja ka vepruar tërësisht në përputhje me Kushtetutën duke ushtruar kompetencat e saj për shpërndarjen e Kuvendit dhe pritet që së shpejti të caktohet edhe data e zgjedhjeve”, përfundoi Gruda.

## Haxhiu: S’mund të thërras seancë, dekreti i Osmanit është jokushtetues

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka përsëritur të hënën se beson që dekreti i presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani për ta shpërndarë Kuvendin është jokushtetues dhe që përderisa të mos ketë një vendim nga Gjykata Kushtetuese, ajo nuk mund të thërrasë seancë.
Sipas saj, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje (VV) do ta çojë shpejt në Gjykatën Kushtetuese këtë lëndë për shqyrtim. “Nëse ka dekret për shpërndarje të Kuvendit, Kuvendi nuk mund ta vazhdojë punën. Nëse Gjykata Kushtetuese do të marrë masë të përkohshme, natyrisht që rrethanat do të ndryshojnë… vendimi i presidentes për të shpërndarë Kuvendin për mua ka qenë befasi, sepse është jokushtetues, është i ngutshëm dhe si i tillë do ta kundërshtoj edhe si kryetare e Kuvendit”, tha Haxhiu.

# CAKOLLI: ZGJEDHJET JANË OPSIONI MË I KEQ NË KËTË FAZË




**Prishtinë, 9 mars** - Në situatën aktuale kushtetuese, Eugen Cakolli, hulumtues në KDI, ka theksuar se Gjykata Kushtetuese duhet të veprojë shpejt dhe të shqyrtojë mundësinë e vendosjes së një mase të përkohshme lidhur me dekretin e presidentes, në mënyrë që të shmanget një krizë edhe më e thellë institucionale.
Sipas tij, ndonëse sipas parimit të ligjshmërisë dekretet konsiderohen të vlefshme derisa të vërtetohet e kundërta nga gjykata, paqartësitë kushtetuese në këtë rast kërkojnë reagim të menjëhershëm. “Edhe pse sipas parimit të ligjshmërisë dekretet janë të ligjshme derisa të vërtetohet e kundërta në gjykatë, për shkak të paqartësisë kushtetuese që kemi në këtë situatë është tejet e rëndësishme që gjykata ta trajtojë me prioritet lëndën dhe potencialisht të vendosë edhe masë të përkohshme mbi bazë ‘ex-officio’, nëse një kërkesë e tillë nuk është paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje”, ka thënë ai.
Cakolli ka paralajmëruar se nëse nuk ndërmerren hapa të tillë, vendi mund të përballet me një cikël të kontestuar institucional, duke kujtuar edhe një rast të mëhershëm të vendimmarrjes kushtetuese. “Çfarëdo situate ku mund të hyjmë në një cikël të kontestuar do të rrezikonte që vendi të përsërisë skenarin që e kemi pasur me rastin e zgjedhjes së nënkryetarëve, kur gjykata konstatoi se procedura nuk kishte qenë kushtetuese, por ndërkohë Kuvendi ishte shpërndarë dhe vendi kishte shkuar në zgjedhje pas një procedure që në esencë ishte jokushtetuese”, ka theksuar Cakolli për “Ekonomia Online”.
Sipas tij, praktika e deritanishme tregon se Gjykata Kushtetuese ka vepruar shpeshherë me prioritet në raste të ndjeshme. “Gjykata në të kaluarën ka treguar se ka trajtuar me prioritet raste të tilla dhe ka vendosur edhe masa të përkohshme pa iu kërkuar fare nga palët, prandaj pres që brenda kësaj jave, nëse jo brenda ditëve aktuale, të vendoset për një masë të përkohshme si mënyra e vetme për të parandaluar një shkelje edhe më të rëndë dhe cenimin e interesit publik”, ka shtuar ai.
Ai gjithashtu ka vlerësuar se zgjedhjet në këtë moment do të ishin opsioni më i pafavorshëm për vendin. “Pas krizave të njëpasnjëshme kushtetuese që kanë derivuar nga situata politike, zgjedhjet janë opsioni më i keq i mundshëm në këtë fazë, sidomos në raport me proceset reformuese dhe funksionin ligjvënës e mbikëqyrës të institucioneve”, ka thënë ai.
Sipas Cakollit, vendi tashmë po hyn drejt vitit të dytë me institucione jo plotësisht funksionale, gjë që mund të minojë besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore.




# NË KRAH TË SHBA-së KUNDËR IRANIT, SA E SIGURT ËSHTË KOSOVA?

Kosova mbështeti ShBA-në në operacionin kundër Iranit, duke riafirmuar qartë pozicionimin e saj në aleancën perëndimore dhe duke dënuar regjimin iranian. Ekspertët ushtarakë nuk e shohin Kosovën si cak prioritar të Teheranit, por theksojnë se vendi nuk është plotësisht i paprekshëm nga zhvillimet e konfliktit

**Prishtinë, 9 mars-** Shumë shpejt pasi bombat e para ranë mbi Iran - duke ndezur një konflikt që brenda orësh mori përmasa rajonale - autoritetet e Kosovës nxituan të dilnin në krah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dënuan regjimin iranian dhe riafirmuan mbështetjen e tyre për aleancën perëndimore.

Presidentja Vjosa Osmani tha se, falë udhëheqjes së ShBA-së dhe presidentit Donald Trump, koha e lirisë për popullin e Iranit po vjen.

Në një reagim në X, ajo shtoi se Kosova do të vazhdojë t'i mbështesë veprimet e ndërmarra nga ShBA-ja dhe aleatët e tjerë për t'i dhënë fund regjimit iranian, ndërsa dënoi fuqishëm sulmet e këtij të fundit kundër aleatëve në Lindjen e Mesme.

Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli nisën sulmet e përbashkëta kundër Iranit më 28 shkurt, me synimin për të frenuar programin bërthamor të këtij vendi. Në kundërpërgjigje, Irani dhe mbështetësit e tij po godasin objektiva në vendet aleate të ShBA-së - nga Arabia Saudite deri në Qipro - pavarësisht paralajmërimeve të Trumpit kundër hakmarrjes. "Më mirë mos ta bëjnë këtë, sepse, nëse e bëjnë, do t'i godasim me një forcë që nuk është parë kurrë më parë", shkroi Trump në rrjetin Truth Social.

Disa orë pas nisjes së sulmeve, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mblodhi Këshillin e Sigurisë për të diskutuar situatën, dhe tha se Kosova po monitoron nga afër implikimet e mundshme për vendin dhe rajonin.

Qeveria e tij nuk iu përgjigj Radios Evropa e Lirë mbi implikimet e mundshme apo masat konkrete që mund të merren. Po ashtu, as Presidenca, as Ministria e Punëve të Brendshme, as Policia e Kosovës dhe as Departamenti amerikan i Shtetit nuk dhanë asnjë koment.

Kosova strehon kampin Bondsteel - bazën më të madhe ushtarake të Shteteve të Bashkuara në Ballkan - dhe rreth 600 ushtarë amerikanë, që shërbejnë në kuadër të misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR.

Në një përgjigje dhënë Radios Evropa e Lirë, një zyrtar i NATO-s tha se KFOR-i vazhdon të përmbushë mandatin e tij për të siguruar një mjedis të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës. "Forca dhe pozicioni i KFOR-it rishikohen dhe përshtaten herë pas here, sipas zhvillimeve të situatës, në mënyrë që misioni të mbetet i efektshëm për qëllimin e tij. Aktualisht, nuk po shqyrtohen ndryshime të rëndësishme", tha zyrtari i NATO-s.

Irani dhe mbështetësit e tij sulmuan disa baza dhe misione të Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tyre në Lindjen e Mesme. Një bazë britanike në Qipro ishte gjithashtu shënjestër e sulmeve me dronë. Autoritetet qipriote thanë se, sipas vlerësimeve fillestare, dronët u lëshuan nga Hezbollahu - grup militant i mbështetur nga Irani - nga territori i Libanit.

Incidenti nxiti reagim të menjëhershëm evropian: disa shtete dërguan avionë luftarakë dhe fregata në Qipro, për të forcuar mbrojtjen ajrore dhe detare të ishullit mesdhetar, mes frikës për një përshkallëzim të mëtejshëm të konfliktit.

Kur bëhet fjalë për Kosovën, ish-zyrtari i lartë i NATO-s, Jamie Shea, argumenton se, edhe pse kampi Bondsteel është një instalim i madh amerikan, ai nuk ka gjasa të renditet ndër objektivat prioritare të Teheranit. Kjo, për faktin se Bondsteel-i nuk është bazë ajrore dhe nuk shfrytëzohet për të mbështetur opereacionet aktuale të ShBA-së kundër Iranit. "Mësa kuptoj, Irani ka në dispozicion një numër të kufizuar raketash balistike. Duke qenë se Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli po godasin platformat e lëshimit të tyre, Irani duhet t'i përdorë ato në mënyrë të zgjuar, për të arritur efektin maksimal", thotë Shea për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Sipas Zyrës së Drejtorit për Zbulim Kombëtar të ShBA-së, Irani ka rezervën më të madhe të raketave balistike në Lindjen e Mesme.

Arsenali i tij përfshin raketa me rreze të gjatë që mund të arrijnë Izraelin, raketa lundruese Kh 55 me rreze deri në 3.000 km dhe dronë Shahed, që besohet se kanë goditur bazën britanike në Qipro dhe arrijnë deri në 2.500 km.

Kjo do të thotë se, nëse lëshohet nga Irani, Ballkani mbetet jashtë rrezes së këtij arsenali.

Ish-komandanti i ushtrisë amerikane në Evropë, Ben Hodges, paralajmëron se brenda rrezes së kërcënimeve të mundshme, mund të jetë baza e Marinës amerikane në Kretë të Greqisë. Ai e konsideron atë si një objektiv të rëndësishëm në Evropë edhe për shkak të rolit të saj logjistik në rajon.

Hodges nuk përmend kërcënime specifike me raketa ose dronë ndaj Bondsteel-it, por thekson se baza duhet të trajtohet gjithmonë si nën rrezik potencial. "Gjithmonë do të supozoja se ekziston një kërcënim, sidomos nëse ka organizata terroriste ose individë që mund të ndjehen të zemëruar për sulmet ndaj Iranit ose për vrasjen e Ajatollahut, dhe vendosin të veprojnë vetë. Prandaj, edhe në kampin Bondsteel duhet të mbahen masat e sigurisë dhe të llogaritet gjithmonë kjo mundësi", thotë Hodges për Exposenë.

Shea thekson se për Evropën, përfshirë Kosovën, kërcënimet më të mundshme të veprimeve iraniane ose të frymëzuara nga Irani, janë sulmet terroriste, sulmet kibernetike dhe sulmet e individëve të njohur si "ujq të vetmuar" - persona të frymëzuar nga ideologji ose grupe, por që veprojnë në mënyrë të pavarur. "Shumë kosovarë iu bashkuan Shtetit Islamik gjatë kohës së kalifatit; disa prej tyre mund të jenë kthyer në vend, disa mund të mbeten ende të radikalizuar. Kjo do të thotë se mund të ekzistojnë disa 'xhepa' të radikalizimit. Dhe, nuk po flas vetëm për Kosovën, sepse situatë e ngjashme mund të shfaqet edhe në vende të tjera të Evropës, brenda komuniteteve myslimane", vlerëson Shea.

Ai paralajmëron se konflikti mund të sjellë edhe rritje të çmimeve të naftës dhe gazit, inflacion më të lartë dhe recesion të madh global. Pasojat

# KOSOVA DHE SHQIPËRIA NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E EKIPEVE TË PËRBASHKËTA HETIMORE

**Prishtinë, 9 mars** - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, Blerim Isufaj, ka pritur të hënën në një takim pune drejtuesin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Klodjan Braho.
Në kuadër të bashkëpunimit, SPAK-u dhe PSRK-ja nënshkruan një marrëveshje për krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore.
Gjatë takimit, Braho dhe Isufaj shprehën gatishmërinë për angazhim të përbashkët me qëllim avancimin e mëtejshëm të koordinimit ndërinstitucional.
Braho riafirmoi rëndësinë e partneritetit me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
Braho u prit në takim edhe nga ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Agron Qalaj, i cili e njoftoi delegacionin nga Tirana për funksionimin e sistemit prokurorial, e në veçanti për funksionimin e Prokurorit të Shtetit, për strukturën organizative, për kompetencat e prokurorive, si dhe për sfidat me të cilat ballafaqohet sistemi prokurorial në realizimin e misionit për sundim të ligjit.
Gjatë këtij takimi u riafirmua angazhimi i përbashkët institucional në funksion të forcimit të sundimit të ligjit në të dyja shtetet, si dhe u diskutua për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit, koordinimin dhe efikasitetin në luftën kundër krimit në të dyja shtetet.
Palët u dakorduan se forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet dy prokurorive në fushën e drejtësisë penale është thelbësor për përballimin e sfidave të përbashkëta dhe trajtimin e çështjeve me interes të ndërsjellë.



## Gjashtë mjekë specialistë i bashkohen Spitalit të Përgjithshëm në Pejë!

Pejë, 9 mars- Ekipi i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë është pasuruar me gjashtë mjekë të rinj që do të kontribuojnë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për pacientët tanë.
Në ekipin e mjekëve tonë janë bashkuar: Dr. Linda Carrabregu - Oftalmologe, Dr. Kaltrine Camaj Blakaj - Gjinekologe, Dr. Melos Kelmendi - ORL, Dr. Rilind Imeraj - Pulmolog, Dr. Kushtrim Mulaj - Pulmolog, Dr. Valmir Muhaxheri - Pulmolog.
Mjekët e rinj u pritën nga drejtori ekzekutiv i Spitalit, dr. Fahri Hasani, dhe drejtori Mjekësor, dr. Shkumbin Berisha, të cilët u uruan mirëseardhje dhe suksese në punën e tyre.
Nga 9 marsi ata kanë filluar zyrtarisht punën në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë.



do të jenë veçanërisht të rënda për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor në tërësi - një rajon që ai e përshkruan si ekonomikisht të brishtë dhe të varur nga investimet e huaja.
E, përveç kësaj, gjenerali Hodges ndan edhe një shqetësim tjetër - sigurinë e qytetarëve evropianë, përfshirë edhe kosovarë, të bllokuar në vendet e Gjirit dhe Lindjes së Mesme. "Nëse janë qindra mijëra evropianë të ngujuar në Emiratet e Bashkuara Arabe, Katar ose vende të ngjashme, për shkak se linjat ajrore janë ndalur, atëherë mund ta kuptoj përse Qeveria franceze mund ta ndiejë nevojën për të dërguar forcën e saj për t'i mbrojtur ata", thotë Hodges.
Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, njoftoi këtë javë se vendi i tij do të dërgojë aeroplanmbajtësin "Charles de Gaulle" në Mesdhe dhe se do të punojë për të formuar një koalicion që do të mbronte trafikun detar, i cili rrezikohet nga përshkallëzimi i krizës në Lindjen e Mesme.
Në kontekstin e masave të sigurisë për Kosovën, Shea sugjeron që autoritetet të forcojnë kontrollin e kufijve, të monitorojnë individët potencialisht të radikalizuar, të



rrisin sigurinë rreth objekteve të ShBA-së dhe KFOR-it, si dhe të forcojnë bashkëpunimin operacional dhe të inteligjencës me NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara. "Natyrisht, ekziston edhe një forcë rezervë e NATO-s që mund të dislokohet nëse situata e kërkon. Por, aktualisht, bëhet fjalë për masa të zakonshme parandaluese. Siguria duhet të përshtatet sipas vlerësimeve të kërcënimeve. Nuk duhet të reagosh më pak, por as ta teprosh me reagimin", thotë Shea.
Me kalimin e çdo dite që lufta vazhdon, rreziqet bëhen gjithnjë e më të paparashikueshme. Hodges thotë se Uashingtoni nuk e ka përcaktuar kurrë qartë se si dëshiron të duket Irani kur lufta të mbarojë - gjë që, sipas tij, e bën konfliktin më të vështirë për t'u përfunduar.
Ai paralajmëron, gjithashtu, për presionin mbi rezervat ushtarake amerikane dhe mbi kapacitetin e përgjithshëm të parandalimit. "Sa më gjatë që zgjat konflikti, aq më shumë vihet në provë aftësia e ShBA-së për të siguruar mjaftueshëm municion. Kjo nuk lidhet vetëm me operacionet aktuale, por edhe me ruajtjen e kapaciteteve të parandalimit ndaj Kinës. Unë jam i sigurt se po ushtrohet presion i madh mbi industrinë, për të rritur prodhimin. Por, këto nuk janë produkte të thjeshta - bëhet fjalë për armë shumë të sofistikuara, të shtrenjta dhe që kërkojnë kohë për t'u prodhuar. Nuk mund të trefishosh apo katërfishosh menjëherë prodhimin e interceptorëve Patriot, sistemeve HIMARS apo raketave Tomahawk", thotë Hodges.
Presidenti Trump tha më 4 mars se forcat e Shteteve të Bashkuara janë në një pozicion shumë të fuqishëm në Iran. Sipas tij, ato kanë bërë një përparim të madh, "edhe pse lufta ka më pak se një javë që ka nisur". Dhe, ndoshta, faktori më i rëndësishëm për këtë është "rindërtimi i ushtrisë gjatë mandatit tim të parë", tha Trump.
Në Ballkan, Ministria e Sigurisë e Bosnje e Hercegovinës rriti masat e sigurisë në një nivel më të lartë, për shkak të përshkallëzimit të konfliktit në Lindjen e Mesme, ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e krahasoi sulmin e ShBA-së ndaj Iranit me fushatën ajrore të NATO-s kundër ish-Jugosllavisë.
Me fjalët e Jamie Sheas, kjo është thjesht një "analogji krejtësisht e rreme" dhe retorikë e përsëritur e Serbisë, e cila ka mbështetjen edhe të Iranit në kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës.
Irani, me një popullsi prej mbi 91 milionë banorësh, nuk e njeh Kosovën si shtet dhe nuk ka marrëdhënie diplomatike zyrtare me vendin.

## 206.9 milionë euro të hyra nga tatimet në dy muajt e parë të këtij viti



**Prishtinë, 9 mars** - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se në dy muajt e parë të këtij viti kanë nisur me një trend të qartë rritjeje të të hyrave tatimore, duke reflektuar rritje të nivelit të përmbushjes së obligimeve tatimore dhe përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve të administrimit fiskal. "Gjatë kësaj periudhe janë mbledhur 206.9 milionë euro të hyra nga tatimet, që paraqet një rritje prej 22.6 milionë euro apo 12.2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo rritje pasqyron jo vetëm performancën e të hyrave, por edhe progresin në forcimin e administrimit tatimor dhe në zgjerimin e bazës së tatimpaguesve që përmbushin obligimet e tyre në mënyrë të rregullt. Autoriteti tatimor mbetet i fokusuar që këtë trend pozitiv ta konsolidojë më tej përmes avancimit të proceseve të punës, përdorimit më të madh të teknologjisë në administrimin tatimor, analizës më të thelluar të riskut dhe intensifikimit të aktiviteteve kundër ekonomisë joformale", ka njoftuar ATK-ja.
Administrata Tatimore e Kosovës rikujton të gjithë tatimpaguesit se afati për dorëzimin e Deklarimit Vjetor të të Ardhurave është deri më 31 mars. "Të gjithë tatimpaguesit inkurajohen që të përmbushin këtë obligim ligjor brenda afatit të përcaktuar, duke shfrytëzuar shërbimet elektronike për një proces më të lehtë dhe më efikas të deklarimit", ka njoftuar ATK-ja.

# BIZNESET KËRKOJNË LEHTËSIM TË PROCEDURAVE PËR MALLRAT TRANZIT NGA PORTI I DURRËSIT

EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 9 mars** - Me kërkesë të bizneseve që importojnë mallra përmes tranzitit nga Porti i Durrësit, të hënën në Odën Ekonomike të Kosovës u mbajt një takim me kryetarin, Lulzim Rafuna.
Në takim morën pjesë përfaqësues të bizneseve që operojnë në fushën e importit dhe që përdorin Portin e Durrësit si pikë hyrëse për mallrat me destinacion tregun e Kosovës.
Gjatë diskutimit, bizneset shprehën shqetësimet e tyre lidhur me procedurat që po aplikohen nga Dogana e Shqipërisë ndaj mallrave që janë në tranzit dhe që kanë destinacion përfundimtar Republikën e Kosovës.
Sipas tyre, ndonëse mallrat janë të destinuara për tregun kosovar dhe trajtohen si mallra tranzit, importuesit po përballen me procedura të zgjatura në Portin e Durrësit, të cilat po zgjasin me ditë të tëra.
Këto vonesa, sipas bizneseve, po shkaktojnë pengesa në furnizim dhe kosto shtesë për aktivitetin e tyre.
Përfaqësuesit e bizneseve theksuan se një praktikë e tillë nuk është në përputhje me parimet dhe procedurat standarde të trajtimit të mallrave në tranzit.
Sipas praktikave doganore ndërkombëtare, mallrat në tranzit duhet të evidentohen dhe regjistrohen në sistemin doganor, ndërsa kontrolli i tyre të kryhet në vendin e destinimit përfundimtar, në këtë rast në Republikën e Kosovës.




Në këtë kontekst, gjatë takimit u theksua nevoja që procedurat për mallrat në tranzit të zbatohen në përputhje me marrëveshjet dhe praktikat për lehtësimin e tregtisë ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.
Po ashtu, u nënvizua rëndësia e rolit të Zyrës së Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit, e cila duhet të sigurojë që mallrat me destinacion Kosovën të trajtohen sipas procedurave të parapara për tranzit, duke u kufizuar në evidentimin dhe përcjelljen e tyre deri në destinacion.
Oda Ekonomike e Kosovës do ta adresojë këtë shqetësim tek institucionet përkatëse, me qëllim që të eliminohen pengesat për bizneset dhe të lehtësohet tregtia ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

# INSPEKTORATI I TREGUT ME MBIKËQYRJE INTENSIVE PËR ÇMIMIN E DERIVATEVE NË TREG

EPOKA E RE Qendresa RAMA




**Prishtinë, 9 mars** - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, ka bërë me dije se në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të tregut të derivateve të naftës, është duke realizuar mbikëqyrje intensive lidhur me zbatimin e vendimit për rregullimin e përkohshëm të çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse të nënshkruar nga ministrja Mimoza Kusari Lila, më 4 mars, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit, rritjen e transparencës, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme si dhe mënjanimin e çrregullimeve në treg.
Gjithashtu, Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut së bashku me Administratën Tatimore të Kosovës është duke realizuar analiza të të dhënave lidhur me çmimet e importit dhe çmimet e ekspozuara për konsumatorët në tregun vendor. "Sipas të dhënave zyrtare të siguruara nga evidencat e Doganës, çmimi mesatar i importit për derivatet e naftës gjatë ditës së shtunë (datë: 07.03.2026), ka qenë si në vijim: 1. Naftë (Dizel): 1.40 euro/litër; 2. Benzinë: 1.14 euro/litër. Ndërkohë, bazuar në monitorimin e realizuar në tregun vendor nga dita e shtunë e deri më tani, çmimet e ekspozuara për konsumatorët në pikat e shitjes me pakicë rezultojnë si më poshtë: 1. Naftë (Dizel): nga 1.39 euro/litër deri në 1.55 euro/litër; 2. Benzinë: nga 1.27 euro/litër deri në 1.32 euro/litër. Bazuar në vendimin e datës 04.03.2026 për rregullimin e përkohshëm të çmimeve dhe caktimit të masave të tjera mbrojtëse është vendosur marzha tregtare maksimale e lejuar si vijon: dy eurocentë për litër të produktit të shitur me shumicë, dhe dymbëdhjetë eurocentë për litër të produktit të shitur me pakicë. Marzhë tregtare domethënë ndryshimi mes çmimit të shitjes dhe çmimit të furnizimit", ka njoftuar Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut.
Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut ka njoftuar se ka qenë në terren gjatë vikendit edhe gjatë ditëve të javës së kaluar. "IQMT do të vazhdojë të monitorojë dhe inspektojë në mënyrë intensive zhvillimet në tregun e derivateve të naftës e po ashtu edhe inspektimin në pajisje matëse, së bashku me Doganën e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës. Kështu që në të gjitha rastet ku identifikohen parregullsi eventuale, si mos respektim i vendimit të marzhës apo praktikave që mund të dëmtojnë konkurrencën dhe konsumatorët, do të ndërmerren masa rigoroze të parapara me legjislacionin në fuqi", ka njoftuar Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut.

## Ministri Krasniqi takon ambasadoren e Finlandës, flasin për menaxhimin e mbeturinave

**Prishtinë, 9 mars** - Ministri për Administrimin e Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka pritur ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Evamari Laaksonen.
Ata zhvilluan një bisedë mbi qeverisjen lokale dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. "Në këtë takim theksuam rëndësinë e forcimit të kapaciteteve të komunave, shkëmbimit të përvojave dhe ndërtimit të partneriteteve mes komunave të Kosovës dhe atyre finlandeze. Diskutuam gjithashtu për bashkëpunim në fusha me rëndësi, si menaxhimi i mbeturinave, përballimi i situatave emergjente dhe mbështetja e programeve që rrisin performancën dhe transparencën në nivel lokal. Bashkëpunimi ndërkombëtar mbetet një shtyllë e rëndësishme për zhvillimin dhe fuqizimin e qeverisjes lokale në Kosovë", ka njoftuar Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal.



# GJIRI PERSIK NË FLAKË: RUSIA DHE KINA HYJNË NË LOJË PËRKRAH IRANIT



Gjiri Persik në flakë: Rusia dhe Kina hyjnë në lojë përkrah Iranit. Dita e shtatë e luftës në Lindjen e Mesme ka sjellë jo vetëm një tjetër valë sulmesh të furishme nga Irani, të drejtuara kundër një cisterne amerikane nafte, objektivave të zakonshme në Gjirin Persik dhe kundër Izraelit, por edhe hyrjen në skenë të dy aktorëve të mëdhenj të kësaj krize.

Rusia dhe Kina, aleatë historikë të Teheranit dhe deri tani relativisht të heshtur, po shfaqen gjithnjë e më hapur në këtë konflikt për shkak të interesave të tyre strategjike dhe energjetike. Prania e tyre kontribuon në krijimin e një tabloje më të qartë të krizës që po zhvillohet në rajon.

Sipas mediave amerikane, zhvillimet po ndjekin pikërisht skenarin e parashikuar nga "regjisorët" e operacionit ushtarak të quajtur "Rrugëtimi i Luanit", përfshirë edhe ndërhyrjen ruse. Gazeta Washington Post raportoi se Moska mund të jetë duke i treguar Teheranit se ku dhe si të godasë.

## Inteligjenca ruse në ndihmë të Iranit

Sipas Uashingtonit, Rusia ka ndarë informacione të rëndësishme me Iranin për të ndihmuar në goditjen e objektivave amerikane me sulme "të sofistikuara" me raketa dhe dronë.

Këto informacione thuhet se janë furnizuar që në fillim të konfliktit dhe do të përbënin një mbështetje të rëndësishme të inteligjencës për Teheranin. Megjithatë, presidenti amerikan Donald Trump ka deklaruar se ndihma ruse "nuk po bën diferencën".

Ndërkohë, sulme të reja janë raportuar kundër një baze ushtarake amerikane pranë kufirit me Kuvajtin. Lajmin e konfirmoi Ebrahim Zolfaghari, zëdhënës i shtabit qendror Khatam al-Anbiya, që është i lidhur me Gardën Revolucionare Islamike.

## Sulme në të gjithë rajonin

Në Emiratet e Bashkuara Arabe u interceptuan 9 raketa balistike dhe 109 dronë, ndërsa rreth 70 raketa u lëshuan drejt Izraelit nga Hezbollahu, sipas ushtrisë izraelite.

Në veri të Omanit, në Ngushticën e Hormuzit, një rimorkiator u godit nga municione të paidentifikuara, që dyshohet të jenë iraniane.

Arabia Saudite gjithashtu ka zmbrapsur sulme pranë rajonit qendror Al-Kharj, afër Riadit, ku një raketë lundruese u interceptua dhe u shkatërrua.

Sirenat e alarmit u aktivizuan edhe në Golan, në veri të Izraelit, pas dronëve të lëshuar nga Hezbollahu nga territori libanez.

Dronë të tjerë janë përdorur për të sulmuar aeroportin dhe fushat e naftës në Basra, ndërsa disa sulme iraniane janë raportuar edhe kundër forcave kurde në veri të Irakut.

Shpërthime të fuqishme janë dëgjuar pranë aeroportit të Erbilit, ku ndodhen trupat e koalicionit të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara në rajonin autonom të Kurdistanit irakian.

## Edhe Kina në mbështetje të Teheranit

Por Rusia nuk është e vetmja që po mbështet Iranin.

Sipas CNN, Pekini mund të jetë gati të ofrojë jo vetëm ndihmë financiare të konsiderueshme, por edhe pjesë këmbimi dhe komponentë për raketa.

Tre burime të cituara nga media amerikane thonë se këto furnizime do të ishin thelbësore për të zgjatur konfliktin dhe për të shmangur dobësimin e shpejtë të kapaciteteve ushtarake të Iranit.

Arsyeja është e qartë: ekonomia kineze mbështetet shumë në naftën iraniane. Për këtë arsye, Pekini po ushtron presion të madh për të garantuar kalimin e sigurt të anijeve që transportojnë gaz dhe naftë përmes Ngushticës së Hormuzit, një nga rrugët më strategjike të energjisë në botë. / bota.al




# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Laurinë Gashi fiton medaljen e bronztë në "Podgorica European Cup 2026"



**Podgoricë, 9 mars** - Xhudistja nga Kosova, Laurinë Gashi, ka fituar medaljen e bronztë në turneun "Podgorica Senior European Cup 2026". Në përballjen vendimtare për podium, xhudistja Gashi ka mposhtur me ippon xhudisten nga Mali i Zi, Milana Stevanoviq. Gashi e ka nisur garën me fitore në çerekfinale, ku ka mposhtur me yuko xhudisten nga Gjermania, Soraya Guenther. Në gjysmëfinale, ajo është përballur me polaken Kinga Klimczak, nga e cila është mposhtur me ippon, duke kaluar kështu në luftën për medaljen e bronztë.

# SUPERLIGA E KOSOVËS: DRITA E PARA, DRENICA E FUNDIT

**Prishtinë, 9 mars** - Të hënën është përmbyllur xhiroja e 23-të në Superligën e Kosovës në futboll, ku ka pasur plotë befasi. Ballkani ka pësuar humbje si mysafirë ndaj Llapit në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, me shifrat 2:0. Ky rezultat ia ka mundësuar Dritës që të qëndrojë në krye të renditjes pas kësaj jave, me 42 pikë, tri më shumë se sa portokallezinjtë, të cilët para kësaj jave e kryesonin renditjen.

Muhamet Hyseni ka shënuar golin e parë në minutën e 17-të, ndërsa fitore e llapjanëve e ka vulosur Edon Sadriu në minutën e parë të shtesës pas asistimit të Arbnor Ramadanit. Këto tri pikë janë shumë të rëndësishme për skuadrën e drejtuar nga Tahir Batatina në garën për t'iu shmangur zonës së rrezikshme në tabelë. Tani Llapi ngjitet në vendin e shtatë me 26 pikë. Humbje si mysafire ka pësuar edhe Prishtina në duel me Malishevën në stadiumin "Liman Gegaj". Në pjesën e parë dallimin e kanë bërë dy penallti, të shënuara nga Etnik Brruti në minutën e 26-të dhe Laurent Xhylani në minutën e 33-të. Prishtina ka mbetur me një lojtar më pak në fushë nga minuta e 32-të, pasi kapiteni Ardian Limani është ndëshkuar me karton të kuq. Ndërkaq, Laurent Xhylani ka vulosur rezultatin në minutën e 73'. Me këtë fitore, Malisheva ka barazuar pikët me Prishtinën, e cila renditet e treta me 37 pikë, pesë më pak se lideri Drita, ndërsa Ballkani



mban vendin e dytë me 39 pikë.

Ndërkohë, Gjilani ka fituar si mysafir ndaj Ferizajt, me rezultat 2:1, me golat e Armend Thaqit, në minutën e 22-të dhe Senad Jaroviq në minutën e 60-të, ndërsa golin e vetëm për Ferizajn e ka realizuar Ade Oguns, në minutën e 40-të. Kjo fitore e tretë rresht i siguron Gjilanit vendin e pestë me 36 pikë, vetëm një më pak se Prishtina dhe Malisheva, ndërsa Ferizaj vazhdon të luftojë në zonën e mbijetesës me 23 pikë. Të shtunën, Drita e ka mposhtur Prishtinën e Re (3:0), ndërsa të dielën Drenica dhe Dukagjini e kanë mbyllur përballjen e tyre në "Bajram Aliu" pa fitues (2:2).

**RENDITJA TABELARE NË SUPERLIGË**

| | |
|---|---|
| Drita | 42 |
| Ballkani | 39 |
| Prishtina | 37 |
| Malisheva | 37 |
| Gjilani | 36 |
| Dukagjini | 33 |
| Llapi | 26 |
| Ferizaj | 23 |
| Prishtina e Re | 22 |
| Drenica | 22 |

# MBAPPE RIKTHEHET NË STËRVITJE ME REALIN, POR PARAQITJA NDAJ CITYT MBETET NË DYSHIM

**Madrid, 9 mars** - Kylian Mbappe është parë sërish në fushën stërvitore në Valdebebas, teksa Real Madrid po përgatitet për ndeshjen e parë të Ligës së Kampionëve kundër Manchester City, e cila zhvillohet nesër (e mërkurë).

Sulmuesi francez i është bashkuar sërish skuadrës pasi ka përfunduar trajtimin konservativ në Paris javën e kaluar, por ai nuk është stërvitur me pjesën tjetër të grupit. Në vend të kësaj, Mbappe ka bërë vetëm vrapime të lehta së bashku me trajnerin francez, Sebastien Devillez, duke e lënë




pjesëmarrjen e tij në ndeshjen e ardhshme ende në dyshim serioz. Mungesa e tij do të ishte një goditje e madhe për trajnerin Alvaro Arbeloa, i cili po përballet edhe me disa mungesa të tjera. Alvaro Carreras ka munguar në stërvitje për shkak të një dëmtimi në muskulin e pulpës së djathtë. Ndërkohë, ka edhe lajme pozitive për madrilenët, pasi Antonio Rudiger është rikthyer në stërvitje dhe pritet të jetë i disponueshëm për ndeshjen, ndërsa Eduardo Camavinga është rikthyer plotësisht me skuadrën pasi ka munguar në ndeshjen e mëparshme. Real Madridi po e monitoron nga afër rikuperimin e Mbappe, por pavarësisht rikthimit të tij në fushën stërvitore, ai nuk pritet të jetë gati për sfidën kundër Manchester Cityt, përveç nëse ndodh ndonjë përmirësim i papritur në momentet e fundit.

# LËNDOHET ILIR KRASNIQI, MUNGON NDAJ SLLOVAKISË?

Zhytomyr, 9 mars - Mbrojtësi i Kosovës, Ilir Krasniqi duket se ka pësuar një lëndim serioz te Polissya Zhytomyr në miqësoren kundër Bereh Kyiv. Mediumet në Ukrainë kanë raportuar se bëhet fjalë për lëndim të rëndë, duke aluduar në këputjen e ligamentit të gjurit, por te Polissya kanë thënë se gjithçka do të konstatohet pas testeve mjekësore. Në rast se konfirmohet lëndimi i rëndë i Krasniqit, atëherë sezoni për mbrojtësin e Kosovës mund të konsiderohet i përfunduar. 25-vjeçari në fillim të këtij viti



është transferuar te Polissya nga Kolosi dhe lëndimi i tij do të ndikonte edhe te Kombëtarja e Kosovës, e cila më 26 mars luan duelin e "play-offit" kundër Sllovakisë. Te Kosova, tashmë është e konfirmuar mungesa e kapitenit Amir Rrahmani për shkak të lëndimit.

## Rikthehen ethet e Ligës së Kampionëve

**Prishtinë, 9 mars** - Sot (e martë) dhe nesër (e mërkurë) do të zhvillohen ndeshjet e para të 1/8 së finales në Ligën e Kampionëve. Përballjet gjatë këtyre dy ditëve do të luhen në dy orare të ndryshme, kurse pothuajse të gjitha ndeshjet pritet të jenë tejet interesante. Sot do të luhen katër ndeshje dhe nesër do të jenë katër duele tjera në kuadër të ndeshjeve të para të 1/8 së finales. Përballja e parë e kësaj faze të Ligës së Kampionëve do të jetë ajo ndërmjet Galatasarayt dhe Liverpoolit, që luhet sot në Stamboll prej orës 18:45. Në të njëjtën ditë, në mbrëmje duke filluar nga ora 21:00 do të luhen ndeshjet: Atalanta - Bayern Munchen, Atletico Madrid - Tottenham dhe Newcastle United - Barcelona. Ndërkohë nesër (e mërkurë), dueli i parë do të jetë ai i orës 18:45 ndërmjet Bayer Leverkusenit dhe Arsenalit, ndërsa nga ora 21:00 të përballen Bodo/Glimt - Sporting, PSG - Chelsea dhe Real Madrid - Manchester City.



# INTERVISTA 'SHPËRTHYESE' E XAVI HERNANDEZ: LAPORTA BLLOKOI KTHIMIN E LEO MESSIT

Pas pothuajse dy vitesh heshtje, Xavi Hernández ka vendosur më në fund të flasë, dhe fjalët e tij mund të tronditin themelet e FC Barcelona.
Në një intervistë të gjatë për gazetën katalanase La Vanguardia, ish-trajneri blaugrana rrëfen për herë të parë çfarë ndodhi në të vërtetë brenda klubit në muajt e fundit të mandatit të tij.
Sipas Xavit, vendimet në Barcelonë nuk merreshin vetëm nga presidenti Joan Laporta, ndërsa një figurë në hije kishte ndikim vendimtar në largimin e tij. Por zbulimi më i fortë lidhet me një tjetër histori: rikthimin e Lionel Messi në Camp Nou.
Sipas ish-mesfushorit legjendar, marrëveshja me Messin ishte praktikisht e arritur dhe kishte edhe miratimin e La Liga-s. Por në momentin e fundit, thotë ai, gjithçka u ndal nga vetë presidenti i klubit.
Në një intervistë që pritet të ndezë debat të madh mes tifozëve dhe brenda vetë Barcelonës, Xavi flet për presionet, intrigat dhe luftërat e brendshme që, sipas tij, po e dëmtojnë klubin nga brenda.
Pas pothuajse dy vitesh heshtje, Xavi Hernández, legjendë e Barcelonës dhe paraardhës i Hansi Flick në stolin blaugrana, ka vendosur të flasë. Siç thotë ai vetë, "për të treguar të vërtetën". Pas më shumë se 40 minutash interviste, Xavi pranon se ndihet "i lehtësuar". Ka shumë gjasa që kjo intervistë të diskutohet për vite me radhë.



**Pse vendose të flasësh tani?**
Për disa arsye. Kryesorja është që dua të tregoj versionin tim të së vërtetës. Pas largimit tim vendosa të mos bëja deklarata nga respekti për Barçën. Njerëzit e dinë sa shumë e dua klubin. E gjithë familja ime është culé.

**Atëherë pse tani?**
Sepse versioni që po tregohet nga klubi është plotësisht i rremë dhe ndiej nevojën të shpjegohem. Kam mbajtur shumë gjëra brenda dhe dua t'i sqaroj.

**A të pëlqen skuadra e Flick?**
Shumë. Është një ekip dominues dhe sulmues. Tifozët e Barcelonës po e shijojnë dhe unë jam i lumtur sepse mendoj se ne vendosëm baza shumë të forta që projekti të vazhdojë. Boshti i ekipit është Lamine Yamal, Pedri, Balde, Cubarsí, Fermín, lojtarë te të cilët ne besuam. Kjo është një nga trashëgimitë për të cilat jam më krenar, përtej dy trofeve që fituam.

**Si është marrëdhënia jote me Flick?**
Shumë e mirë. Shkëmbejmë shpesh mesazhe. E përgëzoj për skuadrën dhe flasim për futboll. Madje një herë erdhi në shtëpinë time për shkak të një situate të vështirë.

**Çfarë ndodhi?**
Ai erdhi të kërkonte falje pasi e pyeta nëse klubi po fliste me të ndërkohë që unë isha ende trajner. Ishin ato dy-tre javë kur klubi kishte vendosur të më largonte, por askush nuk ma thoshte në sy.
Ai erdhi dhe më tha se klubi i kishte kërkuar të mos më thoshte asgjë. Folëm për më shumë se dy orë. Është një njeri shumë i mirë dhe jam i lumtur që gjërat po i shkojnë mirë.

**A flet ende me lojtarët?**
Po. Kam marrëdhënie shumë të mira me ta. I përgëzoj shpesh dhe jam krenar për ta. Në dhomat e zhveshjes ne ishim një familje.

**Nuk të vjen keq që nuk i stërvit më?**
Jo. Përkundrazi, jam i lumtur për ta. Ne firmosëm me Raphinha, Christensen, Lewandowski, Koundé, gjithçka ishte planifikuar bashkë me Jordi Cruyff dhe Mateu Alemany.

**A bëtë gabime?**
Sigurisht. Por gabimi më i madh ishte se kërkesat e mia ndaj klubit u ulën me kalimin e kohës. Kur erdha nga Katari, i thashë presidentit se nëse nuk firmosnim me disa lojtarë nuk do të vazhdoja. Ai më dëgjoi. Fituam La Ligën dhe ishim konkurrues kundër Realit të Madridit. Por më vonë niveli i kërkesave ra dhe kjo është diçka për të cilën e kritikoj veten.

**Në çfarë kuptimi?**
Kur Sergio Busquets u largua, kërkova të firmosej me Zubimendi, por më thanë jo për arsye financiare. Pastaj Jordi Cruyff u largua për shkak të mungesës së respektit. Një muaj e gjysmë më vonë larguan edhe Mateu Alemanyn. Në atë moment edhe unë duhej të largohesha.
Marrëdhënia me Laportën ishte shumë e mirë…
Po. Falë tij u bëra trajner i Barcelonës. Por në fund ai më zhgënjeu.

**Pse?**
Sepse më largoi pa më thënë të vërtetën, i ndikuar nga një person që mendoj se është mbi presidentin: Alejandro Echevarría.

**Po thua se ai të largoi?**
Po. Praktikisht Barça drejtohet nga Echevarría. Ai ishte mik i imi shumë i afërt dhe ky është zhgënjimi më i madh.

**Çfarë ndodhi konkretisht?**
Në janar të sezonit tim të fundit thashë se nga qershori nuk do të vazhdoja. Por kur skuadra vazhdoi të fitonte, ata më kërkuan të qëndroja. Pastaj erdhi eliminimi nga PSG në Champions dhe gjithçka ndryshoi.

**Darka e famshme me sushi?**
Po, në shtëpinë e presidentit. Laporta më tha: "Xavi, nuk e imagjinoj skuadrën pa ty. Nuk e imagjinoj Camp Nou-n e ri pa ty." Dhe unë pranova të vazhdoja.

**Çfarë shkoi keq?**
Në një mbledhje planifikimi, Echevarría filloi të bërtiste duke thënë se përgatitja fizike ishte katastrofë. Por kjo nuk ishte e vërtetë. Të dhënat tregojnë se që nga 2003 nuk ka pasur një Barça që ka vrapuar më shumë se skuadra jonë që fitoi La Ligën. Kjo ishte thjesht një histori për të më larguar.

**Si i përjetove ato javë?**
Ata nisën një fushatë mediatike kundër meje. Madje Echevarría u tha disa lojtarëve, si Sergi Roberto, Araújo, Pedri dhe Raphinha, se unë doja t'i shisja.

**U përfol për një listë largimesh…**
Kjo më dhemb ende sepse nuk është e vërtetë. Ne kishim planifikuar vetëm një shitje për shkak të kufizimeve financiare.

**Cili ishte lojtari?**
Preferoj të mos e them nga respekti për të.

**Po flet nga hidhërimi?**
Jo. Po flas nga ndjenja e drejtësisë. Dua që njerëzit të kuptojnë se gjërat në Barcelonë nuk po funksionojnë mirë. Klubi ka nevojë për ndryshim nga lart poshtë.

**A flet ende me Messin?**
Po. Kemi marrëdhënie të mirë.

**A mund të ishte kthyer Messi?**
Po. Dhe këtu presidenti nuk po thotë të vërtetën. Në janar 2023, pasi fitoi Kupën e Botës, ne filluam të flasim për rikthimin e tij. Kishim edhe dritën jeshile nga La Liga.

**Çfarë ndodhi?**
Presidenti u tërhoq. Laporta më tha fjalë për fjalë: "Nëse Messi kthehet, do të bëjë luftë kundër meje (Laportës)." Pas kësaj, Messi ndaloi së më përgjigjuri në telefon.

**Do të kthehesh ndonjëherë te Barcelona?**
Në këtë pikë mendoj se nuk do të kthehem më kurrë. Koha ime si lojtar dhe trajner ka përfunduar.

**Si ndihesh tani që fole?**
Më i qetë. Unë u largova sepse u përballa me Alejandro Echevarrían. / Në shqip nga bota.al

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Eox Ballkan" Sh.p.k.

Kaçanik i Vjetër, kërkesa për vazhdimin e Lejes Mjedisore, sipas kopjes fizike me

Nr.Prot.25/7577/MMPHI/658/DMMU, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin Eoxide LQ 75 në

Kaçanik i Vjetër, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 01.04.2026, në ora: 10:00, në hapësirat administrative të "Eox Ballkan" Sh.p.k.

(https://maps.app.goo.gl/NbGkTDG9wtSbcBbK6 ), do të organizohet debat publik nga operatori "Eox Ballkan" Sh.p.k. Kaçanik i Vjetër, kërkesa për vazhdimin e Lejes Mjedisore, sipas kopjes fizike me Nr.Prot.25/7577/MMPHI/658/DMMU, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin Eoxide LQ 75 në Kaçanik i Vjetër, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infratrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

https://us05web.zoom.us/j/2748380394?pwd=uhbzpPaPsaC0c4kPxFW0PiLJMgFaia.1

Meeting ID: 274 838 0394

Passcode: eG7xKF

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për

komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=eox

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

"Eox Ballkan" Sh.p.k.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Leapify" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812119122 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Leapify" D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812119122 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Leapify" L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812119122 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.







## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Samir Lushaku shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr.330636178.

- Sevdije Ibriqi shpall të pavlefshme Diplomën e Gjimnazit "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" Drenas.

- "Central Europe Soulutions" L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 812269167.

- "Priam dev" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- N.T.SH "Creative", me seli në Gjakovë shpall të pavlefshme numrin e certifikatës së biznesit: 810244997, të lëshuar nga MTI.

- Aferdita Qabrati shpall të pavlefshme dëftesën e klasës I-VIII të lëshuar nga SHFMU "Vëllezërit Frashëri", Planej.

- Mihill Gjovelekaj shpall të pavlefshme diplomën e QK "11 Marsi", Prizren.

- Gjatë gjithë muajit mars, të gjitha gratë do të përfitojnë 40% zbritje në regjistrim dhe shërbimet e auto shkollës.

- Kjo iniciativë vjen si një shenjë vlerësimi dhe respekti për gratë, duke u ofruar atyre mundësi më të lehtë për t'u pajisur me patentë shoferi dhe për të fituar pavarësi në komunikacion.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës "Trimi" SH.P.K. gjatë orarit të punës.

Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës "Gjin Gazulli" Prishtinë.

Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale "Dituria" Prizren.

Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Kuvendi i Juniku" Junik.

Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Xhelal Hajda Toni" Ratkoc Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE
Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Rregullores për Procedurat e Punësimit dhe Menaxhimit të Marrëdhënies së Punës në NPB – SH.A. Prishtinë, Nr. Protokolli: 01-143/2, datë 10 Shkurt 2026 dhe Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës Nr. Protokolli: 01-336/2, datë 11 Mars 2025, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

***K O N K U R S***

***Për plotësimin e vendit të punës***

**Titulli i vendit të punës:** Inxhinier/e Mbikëqyrës/e dhe Projektues/e në Punët e Instalimeve të Elektrikës 1 (një) pozitë.

**I raportom:** Udhëheqësit/es të/së Divizionit për Planifikim dhe Projektim
**Niveli i pagës:**: 4.2
**Orët e Punës**: 40 orë në javë
**Kohëzgjatja e Kontratës**: Me kohë të caktuar 6 muaj ( puna provuese 6 muaj)
**Vendi Punës**: Rr. "Zija Shemsiu" nr. 22, Ulpianë- Prishtinë ( selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

**Detyrat e përgjegjësitë:**

a) Është përgjegjës/e për realizimin e objektivave të caktuara nga Udhëheqësi/ja i/e Divizionit dhe Menaxheri/ja i/e Departamentit të Planifikimit, Projektimit dhe Mbikëqyrjes (DPPM);
b) Ndihmon Udhëheqësin/en e Divizionit bashkë me zyrtarët e lartë të tjerë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave për DPPM-në;
c) Bashkëpunon ngushtë me zyrtarët tjerë në kuadër të Divizionit dhe Departamentit për përmbushjen e objektivave të DPPM-së;
d) Merr pjesë në mbledhjet e rregullta bashkë me Udhëheqësin/en i/e Divizionit;
e) Bën projektimin e instalimeve të elektrikës për projektet që janë në objektivin e menaxhmentit të NPB-së;
f) Bën harmonizimin e projekteve të instalimeve elektrike me projektet e arkitekturës, statikës, ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit dhe kanalizimit, komunikacionit si dhe me projektet e infrastrukturës rrugore;
g) Konsulton dhe zbaton rregullativën ligjore nga lëmia e inxhinierisë së ndërtimit, respektivisht inxhinierisë elektike duke përfshirë politikat dhe masat e domosdoshme për promovimin dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë;
h) Mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e ndryshme për planifikim, projektim dhe mbikëqyrje;
i) Përgatit paramasat dhe parallogaritë në lidhje me aktivitetet e instalimeve të elektrikës për ndërtimin e objekteve të ndryshme sipas planifikimit të NPB-së;
j) Mbikëqyr dhe kontrollon zbatimin e planeve dhe aktiviteteve operative në lidhje me punët e instalimeve elektrike të përcaktuara nga Udhëheqësi/ja i/e Divizionit dhe Menaxheri/ja i/e Departamentit përkatës;
k) Menaxhon punët e instalimeve të elektrikës gjatë operimit teknik, programit të ndërtimit, adaptimit, renovimit, enterierit të ndërtesave të banimit, afarizmit dhe ndërtesave apo/dhe projekteve tjera;
l) Bën mbikëqyrjen profesionale të projekteve të elektrikës sipas projektit kryesor, kontrollon dhe aprovon situatat e përkohshme gjatë realizimit të projekteve;
m) Kontrollon dhe vërteton cilësinë e instalimeve elektrike në bazë të rregullave, standardeve dhe normativave teknike;
n) Bën kontrollimin, evidentimin dhe firmosjen e dokumentacionit relevant gjatë projektimit dhe realizimit të projekteve (p.sh. raportet e ndryshme, situacionet mujore, etj.);
o) Monitoron ekipet operative që janë në terren në funksion të realizimit të detyrave dhe aktiviteteve të punës konform planit të përcaktuar për projektim, zhvillim, mbikëqyrje dhe dorëzim;
p) Ofron udhëzime për kryerësin e punimeve në zbatimin e planeve dhe aktiviteteve operative për çështjet e lidhura me aktivitetet e instalimeve të elektrikës;
q) Menaxheri/ja i/e Departamentit dhe Udhëheqësi/ja i/e Divizionit mund t'a ngarkojnë me detyra tjera që lidhen me funksionin sipas nevojës së NPB-së;
r) Në rast të mungesës së zyrtarëve tjerë me urdhër të menaxhmentit mund të zëvendësojë dhe të kryejë detyra tjera.

**Kualifikimet:**

- Diplomë Universitare në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike - Drejtimi Elektroenergjetikë;
- Përvojë pune së paku 2 vite nga kjo lëmi;
- Kurse dhe trajnime tjetra gjatë karrierës profesionale;
- Preferohet patentë shofer, kategoria B.

**Aftësitë:**

- Aftësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet kompjuterike në fushën e teknikës si AutoCAD, ArchiCAD;
- Aftësi kompjuterike në aplikacionet e Microsoft Office;
- Njohja e gjuhës angleze e preferueshme;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve lidhur me çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Aftësi të punojë në ekip, të ketë vetë iniciativë dhe qasje konstruktive;
- Shkathtësi për punë administrative dhe njohuri adekuate për punë në zyre duke përfshirë njohuritë për përpilimin e shkresave adekuate profesionale;
- Shkathtësi të shkëlqyera komunikative, organizative dhe analitike; • Aftësi për punë nën presion dhe të dëshmoj fleksibilitet në punë;
- Etikë në punë dhe integritet.

**Mënyra e aplikimit;**

Aplikimi për këtë konkurs mund të bëhet në mënyrë elektronike, duke dërguar dokumentacionin e kërkuar në adresën zyrtare: burimet.njerezore@npbanesore.com. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të bashkëngjitura në formatin PDF.
Kandidatët që aplikojnë janë të obliguar të shënojnë saktë adresën e banimit, numrin e telefonit kontaktues si dhe adresën elektronike (e-mail).
Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në konkurs do të ftohen në fazat e mëtejshme të procedurës së rekrutimit.

**Dokumentet që duhet të bashkangjiten:**

- Aplikacioni i NPB-së;
- Diplomë universitare në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike - Drejtimi Elektroenergjetikë;
- Dëshmia mbi përvojën e punës së paku 2 vite në këtë lëmi;
- Kurse dhe trajnime tjetra gjate karrierës profesionale;
- Patentë shofer kategoria B ( e preferushme)
- Jetë Përshkrimi (CV);
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga Gjykata, e cila dëshmon që nuk jeni i/e dënuar apo nën hetime (duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psiqike para nënshkrimit të kontratës (vetëm kandidati/ja i/e përzgjedhur)

***Shënim*:**. *Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.*

*Ndërmarrja Publike Banesore ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.*

**Njoftim PËR PRIVATËSINË DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Ndërmarrja Publike Banesore SHA Prishtinë – NPB SHA Prishtinë, me seli në Prishtinë, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, informon kandidatët për punën lidhur me përpunimin e të dhënave personale gjatë procesit të rekrutimit.

1. **Qëllimi i përpunimit:**

Të dhënat personale përpunohen me qëllim të:

- Zhvillimit të procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes;
- Verifikimit të kualifikimeve profesionale;
- Ushtrimit të së drejtës së ankesës;
- Themelimit të marrëdhënies së punës për kandidatët e përzgjedhur.

2. **Llojet e të dhënave që përpunohen:**

- Të dhënat identifikuese (emër, mbiemër, datëlindje, numri personal);
- Të dhënat e kontaktit;
- Të dhënat mbi arsimin dhe përvojën profesionale;
- Dokumentet mbështetëse të aplikimit;
- Të dhëna të tjera të kërkuara sipas konkursit.

3. **Baza ligjore:**

Përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje të plotë me:

- Ligjin Nr. 06–L/062, datë 30 Janar 2019, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale[1];
- Ligjin Nr. 03/L–212, datë 01 Nëntor 2010, I Punës[2].
- Ligjin Nr. 03/L–087, datë 13 Qershor 2008, Për Ndërmarrjet Publike[3], i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L–111, datë 20 Prill 2012[4] dhe Ligjin Nr. 05/L–009, datë 07 Prill 2015[5];
- Rregulloren Për Mbrojtjen e të Dhënave[6] në NPB SHA Prishtinë, si dhe aktet nënligjore të brendshme.

4. **Afati i ruajtjes:**

- Të dhënat personale të kandidatëve që me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procedurës së rekrutimit pjesërisht apo në tërësi, ruhen deri në tridhjetë (30) ditë, nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat personale të kandidatëve të papërzgjedhur ruhen deri në një (1) vit nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat e kandidatëve të përzgjedhur ruhen në dosjen personale gjatë marrëdhënies së punës dhe më pas sipas legjislacionit arkivor.

5. **Qasja dhe siguria.**Të dhënat personale përpunohen vetëm nga persona të autorizuar dhe m brohen me masa teknike e organizative të përshtatshme.
6. **Të drejtat e kandidatëve:** Kandidatët kanë të drejtë:Të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre;Të kërkojnë qasje në të dhënat e tyre, korrigjim ose fshirje të tyre sipas ligjit;Të paraqesin ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.
7. **Kontakti:**

Për pyetje lidhur me përpunimin e të dhënave personale, kandidatët mund të kontaktojnë:
NPB SHA Prishtinë – Divizioni i Burimeve Njerëzore.
📍 **Lagje** "ULPIANA", **Rr.** "Zija SHEMSIU", **Nr.** 22, 10000, Prishtinë.
burimet.njerezore@npbanesore.com

**Shpallja është e hapur që nga data 09.03.2026 deri më 23.03.2026 në ora 23:59.**

**Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel.: 038 553 311.**

NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE
Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Na osnovu odredbi člana 8. Zakona o radu, Pravilnika o postupcima zapošljavanja i upravljanju radnim odnosima u NPB – AD Priština, br. Protokol: 01-143/2, od 10. februara 2026. godine i Pravilnika o sistematizaciji radnih mesta br. Protokol: 01-336/2, od 11. marta 2025. godine, Javno stambeno preduzeće AD u Prištini, objavljuje:

## KONKURS

Za popunjavanje radnog mesta

Naziv posla: Nadzorni inženjer i projektant u elektroinstalaterskim radovima 1 (jedna) pozicija.

Izveštava: Šefu Odeljenja za planiranje i projektovanje

Nivo plate: 4.2

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje ugovora: Na određeno vreme 6 meseci (probni period 6 meseci)

Mesto rada: Ulica „Zija Šemsiu“ br. 22, Ulpjana - Priština (sedište Javnog stambenog preduzeća)

Dužnosti i odgovornosti:

a) Odgovoran je za ostvarivanje ciljeva koje je postavio Šef Odeljenja i Rukovodilac Odeljenja za planiranje, projektovanje i nadzor (OPPN);

b) Pomaže Šefu Odeljenja zajedno sa drugim višim službenicima u postavljanju ciljeva i razvoju plana rada za ostvarivanje tih ciljeva za OPPN;

c) Tesno sarađuje sa drugim službenicima u Odeljenju i Odeljenju kako bi se ostvarili ciljevi GDPT-a;

d) Učestvuje u redovnim sastancima zajedno sa Šefom Odeljenja;

e) Projektuje električne instalacije za projekte koji su u okviru upravljanja NPB-a;

f) Usklađuje projekte električnih instalacija sa arhitektonskim, statičkim, projektima grejanja, klimatizacije, vodosnabdevanja i kanalizacije, saobraćajne i putne infrastrukture;

g) Konsultuje i sprovodi zakonske propise u oblasti građevinarstva, odnosno elektrotehnike, uključujući politike i mere neophodne za promociju i poboljšanje energetske efikasnosti;

h) Prikuplja, analizira i procenjuje podatke iz različitih oblasti za planiranje, projektovanje i nadzor;

i) Priprema preliminarna merenja i procene vezane za elektroinstalaterske aktivnosti za izgradnju različitih objekata prema NPB planu;

j) Nadgleda i kontroliše sprovođenje planova i operativnih aktivnosti vezanih za elektroinstalaterske radove koje utvrđuje rukovodilac Odeljenja i rukovodilac nadležnog odeljenja;

k) Rukovodi elektroinstalaterskim radovima tokom tehničke operacije, građevinskog programa, adaptacije, renoviranja, enterijera stambenih, poslovnih i drugih zgrada ili/i projekata;

l) Vrši stručni nadzor elektro projekata prema glavnom projektu, kontroliše i odobrava privremene situacije tokom realizacije projekata;

m) Kontroliše i sertifikuje kvalitet elektroinstalacija na osnovu pravila, standarda i tehničkih propisa;

n) Proverava, evidentira i potpisuje relevantnu dokumentaciju tokom projektovanja i realizacije projekata (npr. razne izveštaje, mesečne situacije itd.);

o) Prati operativne timove koji su na terenu kako bi izvršili zadatke i radne aktivnosti u skladu sa definisanim planom projektovanja, razvoja, nadzora i isporuke;

p) Daje uputstva izvođaču radova u sprovođenju operativnih planova i aktivnosti o pitanjima vezanim za elektroinstalaterske aktivnosti;

q) Rukovodilac odeljenja i rukovodilac odeljenja mogu dodeliti i druge zadatke vezane za funkciju po potrebi NPB-a;

r) U slučaju odsustva drugih službenika, po nalogu rukovodstva, može zameniti i obavljati druge zadatke.

Kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma elektrotehnike i računarstva - smer elektroenergetika;
- Najmanje 2 godine radnog iskustva u ovoj oblasti;
- Drugi kursevi i obuke tokom profesionalne karijere;
- Vozačka dozvola, kategorija B je poželjna.

Veštine:

